



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 174, Datë 07.07.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË  
“OST” SH.A. PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETEVE TË INVESTIMIT  
TË KRYER NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “SUPPLY AND INSTALATION OF  
TRANSMISSION METER/DATA CENTER” NGA OST SH.A. TEK OSHEE GROUP  
SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20 gërma “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pika 1.3 e “Licencës për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike” si dhe neneve 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 119, datë 21.07.2016, si dhe nenit 19 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/6 prot., datë 04.07.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “OST” sh.a. për miratimin e transferimit të asetëve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/data center” nga OST sh.a. tek OSHEE GROUP sh.a.”,

**Konstatoi se:**

- Operatori i Sistemit të Trasmetit (OST) sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 944 prot., datë 20.06.2022, ka paraqitur kërkesën për miratimin e transferimit të asetëve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/data center” nga OST sh.a. tek OSHEE GROUP sh.a.
- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë në zbatim të nenit 7 të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se dokumentacioni për qëllim të këtij aplikimi është plotësuar si më poshtë:

Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, , pikat 3, 4 dhe 6.

- Shoqëria OST sh.a. duhet të sjellë listën e detajuar të aseteve, e cila duhet të jetë pjesë integrale e marrëveshjes së lidhur me OSHEE sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “OST” sh.a., për miratimin e transferimit të aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/data center” nga OST sh.a. tek OSHEE GROUP sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**